

20090771325

## L I G J

### **PËR GARANCINË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NDAJ OBLIGIMEVE SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA, TË DEDIKUAR PËR FINANCIMIN E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME DHE PROJEKTEVE TË TJERA PRIORITARE, E CILA DO TË LIDHET NDËRMJET BANKËS INVESTUESE EVROPIANE DHE BANKËS MAQEDONASE PËR MBËSHTETJEN E ZHVILLIMIT**

#### Neni 1

Republika e Maqedonisë e garanton mbulimin e detyrimeve dhe plotësimin e dispozitave të Marrëveshjes financiare për hua, e cila do të lidhet ndërmjet Bankës Investuese Evropiane dhe Bankës Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit sipas Projektit për financimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe projekteve të tjera prioritare (në tekstin e mëtejshëm: Marrëveshje financiare) në shumë prej 100 000 000 EURO, në kushte dhe afate të parapara në Marrëveshjen financiare, nëse Banka Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit nuk i plotëson dhe servison detyrimet nga Marrëveshja financiare.

#### Neni 2

Kushtet dhe mënyrën e shfrytëzimit të huas nga neni 1 të këtij ligji, verifikohen me Marrëveshjen financiare, e cila do të lidhet ndërmjet Bankës Investuese Evropiane dhe Bankës Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit sipas projektit për financimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe projekteve të tjera prioritare.

#### Neni 3

Të gjitha obligimet të cilat dalin nga Marrëveshja financiare nga neni 1 të këtij ligji, si dhe servisimin e huas do ta bëjë Banka Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit nga të hyrat që i realizon, në kushte dhe afate të verifikuara në Marrëveshjen financiare.

#### Neni 4

Afati i pagesës së huas nga neni 1 të këtij ligji është së paku 4 (katër) e më së shumti 12 (dymbëdhjetë) vjet, të kyçur me grejs periudhë prej së paku 4 (katër) vjet për pjesën e Projektit të dedikuar për financimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Afati i pagesës së huas nga neni 1 të këtij ligji është së paku 4 (katër) e më së shumti 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, të kyçur me grejs periudhë prej së paku 5 (pesë) vjet për pjesën e Projektit të dedikuar për financimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Huaja do të tërhiqet më së shumti 25 transha. Vlera minimale e transhave arrin 3 000 000 EURO.

#### Neni 5

Shkalla e kamatës dhe afati i pagesës do të rregullohen për secilin transhë nga huaja ndaras, në ditën e dorëzimit të kërkesës për tërheqjen e mjeteve të huas nga ana e Bankës Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit, në varshmëri të asaj se cila shkallë e kamatës është më e volitshme për Republikën e Maqedonisë (fikse apo variabile).

#### Neni 6

Për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella, të cilat dalin nga Marrëveshja financiare dhe Marrëveshja për garanci, Ministria e Financave dhe Banka Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit obligohen të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.